

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Mirëqenies Sociale, Janar 2025

21.02.2025

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin janar 2025.

Bie numri i përfituesve nga ndihma sociale në Janar 2025, krahasuar me Janar 2024

Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale

	Muaji/Viti		01/2025
	01/2024	01/2025	01/2024
Skema e ndihmës sociale	20,251	17,940	-11.4
Pensionet bazike të moshës	149,381	155,063	3.8
Pensionet kontributpaguese të moshës	48,780	48,209	-1.2
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara	19,938	19,686	-1.3
Pensionet e Trepçës	1,382	1,099	-20.5
Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës	777	867	11.6
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	1,324	1,376	3.9
Skema e të verbërve	1,873	1,815	-3.1
Pensionet Familjare	2,983	2,794	-6.3
Pensionet e Invalidëve të punës	47	39	-17.0
Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike	2,971	3,217	8.3
Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99	13,684	14,326	4.7
Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	12,869	12,641	-1.8
Veteranët	36,851	36,925	0.2
Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	3,286	3,866	17.7

Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin janar 2025, krahasuar me muajin janar 2024, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet e Trepçës (-20,5%); skema për pensionet invalidore (-17,0%); skema e ndihmës sociale (-11,4%); skema për pensionet familjare (-6,3%); skema e kompensimeve për personat e verbër (-3,1%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,8%); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (-1,3%); skema e pensioneve kontribut-paguese të moshës (-1,2%).

Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin janar 2025, krahasuar me muajin janar 2024 kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (17,7%); skema e pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (11,6%); skema për Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike (8,3%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (4,7%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,9%); skema e pensioneve bazike të moshës (3,8%); skema për veteranët e luftës (0,2%).

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin Janar 2025, vizitoni:
<https://ask.rks-gov.net/Themes/SocialWelfare>